



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-568-2013 dt. 24 tetor 2013 për lëshimin e Autorizimit final për shoqërinë "KelKos Energy" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, për njësinë gjeneruese HC Lumëbardhi II që do të vendoset në lokacionin e Lumit Deçan, në Komunën e Deçanit, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për HC Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, të datës 13.07.2015 të shoqërisë "KelKos Energy" sh.p.k., me adresë: rruga "Sali Ceku", Ndërtesa Gogaj, nr. 14 – 51000, Komuna e Deçanit, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "KelKos Energy" sh.p.k.. dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, në lumin Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.



Arsyetim

- ZRRE me datë 13.07.2015 nga shoqëria **“KelKos Energy” sh.p.k.**, ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, në lumin Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
 - Bordi i ZRRE-së me datë 24 tetor 2013, shoqërisë **“KelKos Energy” sh.p.k.**, i ka lëshuar Vendimin V-568-2013 për Autorizimin final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-568-2013 dt. 24 tetor 2013 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën është lëshuar Autorizimi final shoqërisë **“KelKos Energy” sh.p.k.**, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar